


Për: Usmen Baldzi, MASHT – Zëvendës Ministër

Përmes: Bashkim Ibishi, Advancing Together - Drejtor Ekzekutiv

Nga: Genc Broqi, KAAD – Menaxher i Programit



Lënda: Rekomandim për regjistrimin e studenteve ne menzen dhe konviktin e UP.

I nderuari zëvendës ministër Baldzi,

Organizata jo-qeveritare Advancing Together me programin e sajë Roma Versitas Kosovo Program ka për qëllimi që të rrisë normën e ruajtjes së vijimit dhe kapacitetet akademike të studentëve të universitarë, anëtarë të komunitetit Rom, Ashkali, Egjiptian. Projekti synon të përmirësojë shkallën e vijimit, performancës dhe të diplomimit për student me vijim të rregullt të arsimit universitarë në Kosovë duke iu ofruar aftësi akademike. Ky program financohet nga Roma Education Fund – REF, programi Roma Versitas Kosovo implementohet që nga viti 2013.

PËRFITIMET NGA PROGRAMI

Studentët të cilët do bëhen pjesë e Roma Versitas Kosovo Program do të kenë mundësinë që të aplikojnë dhe të përfitojnë këto shërbime:

- I. Shfrytëzimin e Qendrës së Resurseve, Librarin dhe Librarin Elektronike,
- II. Skemën e Tutor-imit (orë mësimore shtesë për lëndët në të cilat studenti konsideron që ka nevojë),
- III. Për studentët e vitit të parë (brucosh-at) skema e Mentori-mit,
- IV. Shërbimet e zhvillimit Akademik (trajtime profesionale me temat: Shkrim Akademik, Menaxhim i Kohës, Aftësi të Komunikimit dhe Prezantimit, Përgatitje e rezumesë dhe përgatitje për intervistë, aftësi të Debatit dhe Intervistës, Përpilimi dhe Shkrimi i Projekt Propozimeve, Cikli i menaxhimit të projekteve),
- V. Kurse të Gjuhëve Angleze dhe Rome si dhe Kurse të Kompjuterëve,
- VI. Mbështetja Vetë-besimi dhe veprimtaritë sociale,
- VII. Projekte nga iniciativat studentore - SIP(grante te financuara për hulumtime shkencore apo implementimin e projekteve të cilat burojnë nga idetë kreative të studentëve),
- VIII. Punë praktike për përvojë dhe përfitim publik.

Ne si program jemi në kontakte të vazhdueshëm me studentët nga radhët e komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptas, ku i ofrojmë shërbimet e lartcekura ku gjatë punës tonë me studentë kemi identifikuar nevojat e tyre për regjistrim në Konvikte dhe në mensën e universitetit të Prishtinës.

Duke u bazuar në udhëzimin administrativ të nënshkruar nga Ministri i Arsimit UA Nr: 09/2016 ne e kemi përpiluar listat në vijim për përkrahjen e studentëve nga radhët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian që tu sigurohen vendet në mensën dhe konviktin e UP në mënyrë që ti mundësojmë vazhdimin e studimeve.

1. Për pranim në konviktet të UP-se në Prishtinë dokumenti Annex 1;
2. Për qasje në mensën e studenteve në Prishtinë dokumenti Annex 2.

Ju lutem të mos hezitoni po që se keni nevojë për më shumë detaje rreth këtyre listave.

Me respekt,

Genc Broqi